



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA “ECO – ELB” sh.a

Elbasan, më .03.2023

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS - “Blerje karburanti naftë D1”

LLOJI PROCEDURËS - “Procedurë e hapur – mallra”- Marreveshje Kuader

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT:

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator ECO ELB sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 te miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertes, sipas shtojces 1;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Kriteret (a-c) jane vendosur ne perputhje me Dokumentat e Tenderit te miratuara nga APP bazuar ne Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar ne Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”

Pika b) eshte vendosur ne baze te nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Çertifikate **ISO 9001-2015 ose ekuivalent** (e vlefshme de e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqipërisë).

2.1.2 Çertifikate **ISO 14001-2015 ose ekuivalent** (e vlefshme de e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombëtare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqipërisë).

2.1.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me liçence per tregtimin me shumicë

VIII. 1.A per kategorinë III/G (Lëndë djegëse për përdorim termik civil dhe/ose industrial).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma “a” dhe nenit 44 të VKM nr.285, datë19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Gjithashtu, Autoriteti kontraktor (AK) kërkon këto certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, për të vërtetuar

pajtueshmërinë e operatoritekonomik ofertuesi me standardet e kërkuara, gjithashtu edhe për të pasur garanci që operatorët ofertuesmbulojnë menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomike duhet te paraqesin vertetim per xhiron vjetore per vitet financiare 2020,2021 ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kërkuar duhet te jete jo me e vogël se vlera e fondit limit te lotit/shumës së loteve për të cilët konkurron. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës se kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021,2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e percaktimeve te nenit 41 te Ligjit Nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet te kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.3 Deklaratë nga Operatori Ekonomik per shlyerjen e taksave vendore te parashikuara nga Pushteti Vendor per vitin 2022, ku të perfshihet kësti për periudhën perkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. (Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vertetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kerkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).

Argumentimi: 2.2.1,2.2.3, 2.2.3Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b** dhe **3** të ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik¹*" në të cilët përcaktohet se, citojmë: "*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:b) gjendjen ekonomike dhe financiare;...3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*"

Në **nenin 43** "*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare*" të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** "*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*" ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: "*1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare..*"

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kurpërmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore sa 40% e vlerës së kontratës bazuar në nenin 43 pika 2 e VKM-së, dhe pasqyrat financiare për vitin e fundit (2020) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Po, ashtu njësia e prokurimit gjykon se bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislationit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuajduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes

financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi 2.3.1 është vendosur referuar nenit 40 pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.3.2 . Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë fletë/raport analizë të lëshuar nga një laborator i certifikuar në Republikën e Shqipërisë për lëndë djegëse Gazoil $\leq 0.1\%$, sipas specifikimeve teknike. Fletë/raport analiza duhet të jetë brenda 3 muajve (tre) nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi :2.3.2 është vendosur referuar nenit 40,pika 5,germa a, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar në nenin 77 të LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës të paraqes një vërtetim nga Inspektoriati Shtetëror Teknik (ISHTI), që subjekti ofertues nuk ka patur shkelje administrative për vitin 2022.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon depozita në pronësi ose me qira në një largësi jo më shumë se 60km nga vendi i AK-Së, faktuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale, akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKR, etj) duke vërtetuar kapacitetet depozituese dhe rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për depozitat

Vërtetim nga Organet e Miratuara te Vlerësimit te Konformitetit (OMVK), i cili duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: 2.3.3 dhe 2.3.4 është vendosur referuar nenit 40,41 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar ne nenin 77 te LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.3.5 Deshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Autobot me kapacitet mbajtës minimum 1000 litra	1	Pronësi ose me qira

a) Për mjetet qe shënohen në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (certifikate pronësie të mjetit); b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; ç) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); d) certifikatën për transportin e lëndëve të rrezikshme; dh) pasaportën e mjetit për kapacitetin mbajtës në litra; e) certifikatë inspektimi të cisternës; e) ADR e mjetit shoqëruar me Leje Drejtimi ADR të shoferit.

b) Për mjetet e marra me qera duhet te paragitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (certifikate pronësie te mjetit); b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; ç) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); d) certifikatën per transportin e lëndeve të rrezikshme; dh) pasaportën e mjetit për kapacitetin mbajtës në litra; e) certifikatë inspektimi të cisternes; ë) ADR e mjetit shoqëruar me Leje Drejtimi ADR të shoferit si dhe kontrata perkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

c) Operatori ekonomik duhet te paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

d) Autoriteti Kontraktor rezervon te drejtën të verifikoje dhe kontrollojë në çdo kohë deri në perfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike te deklaruar. (Deklarate nga administratori i shoqërisë ofertuese). Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtoiçes 8 të DT. Dokumentat e kerkuara me siper do të paraqiten ne rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: 2.3.5 është vendosur referuar nenit 40,pika 5,germa a, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar ne nenin 77 te LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”. Me anë të cilit AK mund të vertetojë se OE ka dhe mund të ve në dispozicion mjetet e nevojshme për realizimin e objekt prokurimit të kësaj procedure.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te deklarojë se merr përsiper në çdo kohë furnizimin me autobot 24 orë, çdo ditë të javës, sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor

Argumentimi:2.3.6 është vendosur referuar nenit 40,pika 5,germa a, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar ne nenin 77 te LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”. Me anë të cilit OE merr përsipër furnizimin me mallin objekt prokurimi me shpenzimet e veta dhe me sherbim 24 orë në vendodhjen e AK

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Njesia e Prokurimit